

ARGUMENTUM

news opinion analysis



**“PA UKRAINËN,
PËR UKRAINËN...**

**Lojërat e fuqive të
mëdha përcaktojnë
trajektoren e re globale”**

- Arrestohet me vendim
të SPAK kryebashkiaku i
Tiranës Erion Veliaj

- Aleanca Euro – Atlantike
në rrezik!

- Kush është Friedrich Merz
kancelari i ri Gjermanisë?!

Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,

Argumentum.al tashmë nga muaji prill 2022 vjen në versionin e një reviste të përmuajshme politike-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online.

Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji. Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.

Argumentum.al përpiqet të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare,

politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpunorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë Argumentum.al është e hapur për komente e mendime të lexuesve të saj.

Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

“Argumentum”, një proces intelektual ...

Marjana DODA
Kryeredaktore

Përmbajtja

03 SHQIPËRI

- Arrestohet me vendim të SPAK kryebashkiaku i Tiranës Erion Veliaj.

04 JO VETEM LAJMI

- Kosova feston 17 vjetorin e pavarësisë!

06 OP/ED

- “Pa Ukrainën, për Ukrainën...lojërat e fuqive të mëdha përcaktojnë trajektoren e re globale”- *Nga Marjana DODA*

10 EKONOMI

- Banka Botërore miraton 120 milionë dollarë për të mbështetur reformat në Shqipëri.

11 JO VETEM LAJMI

- Kush është Friedrich Merz që do drejtojë tani Gjermaninë?!

13 REALPOLITIK

- Europa shtrëngon rradhët! Aleanca Euro – Atlantike në rrezik! SHBA-1945!! Duam Paqe, jo Pushtim!

15 RAJON

- Zgjedhjet parlamentare në Kosovë/ Kush, sa vota mori?
- Mickoski në Uashington: Evropa duhet të jetë parimore dhe jo me standarde të dyfishta.

- Begaj-Milatović: Projekte të përbashkëta në zonat ndërkufitare me Malin e Zi.

20 BOTA

- SHBA–Takim i tensionuar Trump-Zelensky në Shtëpinë e Bardhë.

ENGLISH EDITION

22 ENGLISH TOP NEWS

- The Munich Security Conference and the future of Transatlantic relations. - *By Giuseppe Spatafora*

24 IN FOCUS

- The Road to Prosperity. - *Radosław Sikorski*

26 REALPOLITIK

- Europe tightens the ranks! The Euro-Atlantic Alliance in danger! USA-1945!! A true Peace, not new occupation!

28 BALKAN OVERVIEW

- Serbia's Protests Are a Call Against Kleptocracy – The EU Must Seize the Opportunity.

- Kosovo PM dismisses criticism by Trump envoy, claims U.S.-Kosovo relations never better.

31 GLOBAL

- Polish premier says forced surrender of Ukraine would be surrender of ‘entire Western community’.



Arrestohet me vendim të SPAK kryebashkiaku i Tiranës Erion Veliaj

Kryetari i bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj është shoqëruar sot nga prokurorët e Byrosë Kombëtare të Hetimit, të cilët me urdhër të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) i kanë paraqitur Veliajt masën e sigurisë.

Sipas medieve, ndaj kryetarit të bashkisë së Tiranës është caktuar masa “arrest me burg”. Erion Veliaj është dërguar në bllokun e Sigurisë “Mine Peza”, ndërkohë që pritet të shoqërohet në ambientet e Drejtorisë së Policisë së Tiranës.

Kryebashkiaku Veliaj akuzohet për korrupsion pasiv dhe pastrim parash, ndërsa pritet njoftim zyrtar nga Prokuroria e Posaçme Antikorrupsion. Masa për të është caktuar nga gjyqtari Erjon Bani.

Masa “arrest shtëpie” është caktuar edhe për bashkëshorten e Veliajt, Ajola Xoxën. Ndërsa në detyrim paraqitje janë vendosur Gentian Sula, Meriman Palushi, Fatmir Bektashi, Sokol Kryeziu dhe Shkëlqim Fusha.

Kryetari i bashkisë së Tiranës, është paraqi-

tur disa herë në Prokurorinë e Posaçme Antikorrupsion.

Akuza e SPAK bazohet mbi kallëzimin e personit anonim, Nesti Angoni. Kallëzimi u dërgua me postë në SPAK. Nisur nga kjo u regjistrua dosja në hetim por nuk ishte regjistruar emri i kryebashkiakut si person nën hetim.

Në dhjetor 2024 Kryebashkiaku i Tiranës dëshmoi para agentëve të BKH-së si person që kishte në lidhje me veprën penale të korrupsionit pasiv, ndërkohë që kishte nisur dhe hetim pasuror. Edhe familjarët e tij janë marrë në pyetje si persona që kanë dijeni.

Më 6 dhjetor 2024 SPAK sekuestroi telefonin e bashkëshortes së tij, Ajola Xoxa. Me vendim të GJKKO kontrole u kryen dhe në studion ‘Harabel’ tek ish-Blloku ku u sekuestruan dhe dokumente që kanë të bëjnë me hetimet e nisura nga prokurori Ols Dado, në lidhje me pasurinë e Erion Veliajt dhe familjarëve të tij. Ndërsa i është ushtruar kontroll dhe në banesën e vëllait të Erion Velisë.

KOSOVA FESTON

17 VJETORIN E PAVARËSISË!



“Nën ritmin e hapave të këmbëve të ushtarëve e policëve tanë sot dëgjojmë hapat e luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por edhe hapat e rrugës sonë të përbashkët me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e NATO-s të nisur me 1999 por e cila do të vazhdojë deri në anëtarësimin e Kosovës në NATO dhe Bashkimin Evropian”.



Parakalimi i trupave të Forcës së Sigurisë dhe Policisë së Kosovës, ngritja e flamurit shtetëror si dhe veprimtari të tjera ishin pjesë e shënimeve për nder të 17 vjetorit të pavarësisë së Kosovës. Udhëheqësit e Kosovës rithekuan sakrificën e popullit dhe mbështetjen e aleatëve si thelbësore në shënimin e kësaj dite. “Përkulemi me respekt të thellë për familjen Jashari dhe të gjithë dëshmorët e kombit, të gjithë dëshmorët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e martirët që e bënë këtë ditë të mundshme me sakrificën e tyre të jashtëzakonshme. Historia jonë nuk do të ishte e njëjtë pa mbështetjen

e aleatëve tanë, falenderimi ynë i përjetshëm shkon për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për NATO-n, për shtetet evropiane dhe demokracitë gjithandej botës sikur për të gjithë miqtë ndërkombëtarë që qëndruan me ne në momentet më të vështira dhe na ndihmuan që ta bëjmë të mundur lirinë dhe pavarësinë”, tha presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani.

“Nën ritmin e hapave të këmbëve të ushtarëve e policëve tanë sot dëgjojmë hapat e luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por edhe hapat e rrugës sonë të përbashkët me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e NATO-s të nisur me 1999

por e cila do të vazhdojë deri në anëtarësimin e Kosovës në NATO dhe Bashkimin Evropian”, tha kryeministri i Kosovës, Albin Kurti.

Përvjetori i shtatëmbëdhjetë i pavarësisë e gjen Kosovën në një periudhë të paqartësive e mundësive të hapura për formimin e qeverisë së re të vendit, pas zgjedhjeve parlamentare të nëntë shkurtit.

Vëzhguesit thonë se skenarët e mundshëm të formimit të qeverisë së re që përfshijnë lëvizjen Vetëvendosje me pakicat joserbe apo partitë opozitare të bashkuara, nuk ofrojnë fuqinë e duhur vendimmarrëse përballë sfidave të shumta që e presin

vendin në planin e brendshëm dhe të jashtëm.

Krahas sfidave si përmirësimi i gjendjes ekonomike, arsimit dhe shërbimeve shëndetësore dhe luftimi i varfërisë, në planin e jashtëm qeveria e re do të përballet me dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë dhe me përpjekjet për ripërtëritjen e marrëdhënieve me fuqitë perëndimore, të cilat e kanë kritikuar qeverinë e Kryeministrit Kurti për veprimet e saj në veriu të Kosovës të banuar me shumicë serbe.

Presidenti amerikan, Donald Trump në një mesazh urimi për Presidenten Vjosa Osmani, me rastin e shtatëmbëdhjetë vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, tha se lidhjet midis popujve të të dyja vendeve janë të forta dhe se pret zgjerimin e tyre duke theksuar se “Shtetet e Bashkuara presin të ndërtojnë një marrëdhënie më produktive me qeverinë e Kosovës në vazhdim të vitit”.

Sekretari amerikan i Shtetit Marko Rubio uroi Kosovën në përvjetorin e pavarësisë, duke theksuar se ky është një rast për të reflektuar mbi qëndrueshmërinë, vendosmërinë dhe aspiratat e popullit të Kosovës.

Sekretari Rubio tha në mesazhin e urimit se Shtetet e Bashkuara e kanë mbështetur me krenari rrugëtimin e Kosovës për t’u bërë një vend sovran, demokratik, shumë etnik dhe i begatë.

Ai tha se paqja rajonale, siguria dhe zhvillimi ekonomik mbeten thelbësore për prosperitetin e qëndrueshëm të Kosovës.

Richard Grenell uron Kosovën – Mbajtja e Hashim Thaçit në Hagë është padrejtësi

I dërguari i Presidentit Trump



për misione të posaçme, Richard Grenell uroi siç tha të gjithë miqtë në Kosovë për 17 vjetorin e pavarësisë.

Në një postim në rrjetet sociale, zoti Grenell tha se megjithatë, ky moment historik është lënë nën hije nga një padrejtësi e rëndë. “Babai themelues i shtetësisë së Kosovës, presidenti Hashim Thaçi, duhet të festojë sot në Prishtinë – jo prapa grilave në Hagë”.

Ai shkroi se evropianët nuk kanë arritur të veprojnë siç u shpreh kundër kësaj padrejtësie në pesë vitet e fundit dhe se institucionet shtetërore të Kosovës kanë dështuar të ndërmarrin veprimet e nevojshme ligjore për t’i dhënë fund kësaj padrejtësie për shkak të politikës.

“Ky burgim i padrejtë duhet të marrë fund”, tha zoti Grenell.

Udhëheqës të vendeve të ndryshme si Franca, Gjermania, Italia dhe të tjerë në urimet e tyre u zotuan për mbështetjen e Kosovës në përparimin drejt integritetit euroatlantik, fuqizimin e demokracisë si dhe qëndrueshmërisë në rajon, duke vënë theksin te normalizimi i plotë i marrëdhënieve me Serbinë si diçka thelbësore në këtë proces.

Kosova shpalli pavarësinë e saj më 17 shkurt të vitit 2008, nëntë vjet pasi ndërhyrja e NATO-s i dha fund luftës gati dyvjeçare që la pas vetes mbi dhjetë mijë të vrarë dhe mijëra të zhdukur. Pavarësia e saj është njohur nga më shumë se 100 vende të botës, ndërsa vazhdon të kundërshtohet nga Serbia me mbështetjen e Ruisë dhe Kinës.

“PA UKRAINËN, PËR UKRAINËN...”

Lojërat e fuqive të mëdha përcaktojnë trajektoren e re globale”



NGA MARJANA DODA

N donëse Vladimir Putin nuk e fitoi luftën për tre ditë...ai qartazi po e fiton atë pas tre vitesh...por me kosto shumë herë më të larta jo vetëm për Ukrainën, por tashmë dhe për vetë Europën.

Pas tre vitesh rezistence ndaj agresionit rus, Ukraina po përjeton një nga periudhat më sfiduese; humbjen e mbështetjes së pakufizuar nga SHBA-të, humbje territoriale dhe materiale, si dhe një pasiguri të re që shfaqet në horizont. Kjo pasiguri shtohet dhe nga dyshimet që ka Evropa për sigurinë e saj përballë një rendi të ri botëror.

Lufta e Rusisë në Ukrainë ka sjellë një ristrukturim të rëndësishëm të marrëdhënieve ndërkombëtare, duke pasur ndikim të drejtpërdrejtë në politikën,

ekonominë dhe sigurinë globale. Konflikti thelloi ndarjen mes shteteve perëndimore dhe Rusisë, duke forcuar aleancat si NATO dhe Bashkimin Evropian.

Kjo u nënvizua në vitin e parë të luftës së Rusisë ndaj Ukrainës, por këto aleanca janë tronditur pas ardhjes së Presidentit Trump në Shtëpinë e Bardhë. Trump duket se po ravijizon marrëdhëniet me Bashkimin Evropian. Ndërsa me Ukrainën ai duket se po imponon kushtet për paqe...kësaj here jo ndaj Rusisë por këto kushtëzime i drejtohen pikërisht vendit të sulmuar, Ukrainës.

Ukraina vërtetë po ndryshon jo vetëm hartën politike, por gjithashtu po riformaton dinamikën ekonomike dhe strategjike të një bote që po kalon nëpër transformime të shpejta dhe të thella. Bota po ndryshon para

Ukraina vërtetë po ndryshon jo vetëm hartën politike, por gjithashtu po riformaton dinamikën ekonomike dhe strategjike të një bote që po kalon nëpër transformime të shpejta dhe të thella. Bota po ndryshon para syve tanë! Megjithatë, në këtë periudhë të pasigurt dhe të turbullt, duket se fuqitë e mëdha, për shkak të interesave të tyre gjeopolitike, janë të gatshme të lënë Ukrainën të vetme, madje duket se dy nga fuqitë e mëdha globale janë bërë bashkë për ta coptuar Ukrainën.

syve tanë! Megjithatë, në këtë periudhë të pasigurt dhe të turbullt, duket se fuqitë e mëdha, për shkak të interesave të tyre gjeopolitike, janë të gatshme të lënë Ukrainën të vetme, madje duket se dy nga fuqitë e mëdha globale janë bërë bashkë për ta coptuar Ukrainën.

Por le të flasim fillimisht për atë çfarë ndodhi më 24 Shkurt 2022;

Më 24 shkurt 2022, Rusia nisi një pushtim të gjerë të Ukrainës, një vend fqinj në jugperëndim, duke shënuar një përshkallëzim të madh të konfliktit të vazhdueshëm ruso-ukrainas që kishte filluar në vitin 2014. Ky pushtim u pasua nga një rritje të vazhdueshme të aktiviteteve ushtarake ruse dhe nga një krizë që kishte nisur në fillim të vitit 2021, gjatë së cilës presidenti rus Vladimir Putin kritikoi zgjerimin e NATO-s pas vitit

1997, duke e cilësuar atë si një kërcënim për sigurinë e Rusisë. Ai gjithashtu kërkoi që Ukraina të ndalohej ligjërisht të bashkohen me aleancën euroatlantike. Disa ditë përpara pushtimit, Rusia njohu zyrtarisht dy shtete të vetëshpallura brenda kufijve të Ukrainës: Republikën Popullore të Donetskut dhe Republikën Popullore të Luhanskut. Më 21 shkurt, Forcat e Armatosura Ruse hynë në rajonin e Donbasit në Ukrainën lindore. Më 22 shkurt, Këshilli i Federatës Ruse miratoi një vendim që autorizonte përdorimin e forcës ushtarake jashtë kufijve të Rusisë.

Më 24 shkurt, Putin shpalli “operacionin special ushtarak” në Ukrainën lindore; pak minuta më vonë, sulmet me raketa filluan në të gjithë Ukrainën, përfshirë kryeqytetin Kiev.

Ukraina vendosi ligjin ushtarak, tha presidenti Volodymyr Zelensky në një fjalim të improvizuar video që ai publikoi në Facebook. Zelensky tha gjithashtu se ai zhvilloi një telefonatë me presidentin amerikan Joe Biden. “Shtetet e Bashkuara tashmë kanë filluar të konsolidojnë mbështetjen ndërkombëtare”, theksoi në atë kohë presidenti i Ukrainës.

Kështu, pushtimi i Ukrainës nga Rusia më 24 shkurt 2022 shënoi një moment të rëndësishëm në historinë e marrëdhënieve ndërkombëtare, duke pasur pasojë të thella për sigurinë evropiane dhe për sistemin e rendit botëror pas Luftës së Dytë Botërore. Sot, ndërsa shënohen tre vite që prej fillimit të këtij konflikti, të cilin Rusia e konsideron një “operacion special ushtarak” dhe Perëndimi e trajton



si agresion, dinamika e luftës ka sjellë kthesa të papritura dhe pasoja që nuk kufizohen vetëm në Ukrainë, por që janë shtrirë në nivel global, duke ndikuar edhe në marrëdhëniet mes fuqive të mëdha dhe duke krijuar pasiguri për të ardhmen e kontinentit europian

“Fuqitë e mëdha bëhen bashkë dhe kundër Ukrainës”

Presidenti rus Vladimir Putin dhe Presidenti i SHBA-së Joe Biden u takuan në Gjenevë në vitin 2021, në një moment kyç të marrëdhënieve ndërkombëtare, ku çështja e Ukrainës ishte një nga temat kryesore të diskutimit. Diskutimi për situatën e Ukrainës, por pa përfshirjen e një delegacioni ukrainas, shkaktoi shqetësim dhe pakënaqësi në qeverinë e Kievit. Ukraina u ndje e lënë mënjanë në një çështje kaq të rëndësishme që prekte drejtpërdrejt sigurinë dhe integritetin e saj territorial.

Megjithatë, presidenti i SHBA, Joe Biden, e siguroi udhëheqjen ukrainase se Shtetet e Bashkuara ishin plotësisht të angazhuara për mbështetje ndaj Ukrainës

dhe se do të vazhdonin të ishin aleatë të fuqishëm, veçanërisht në lidhje me mbrojtjen e sovranitetit të saj dhe në përballimin e kërcënimeve të mundshme nga Rusia. Ky angazhim u shoqërua me garancitë e vazhdueshme të mbështetjes për Ukrainën në fushën diplomatike, ushtarake dhe ekonomike.

SHBA dhe Europa u angazhuan çdo ditë me kërcënime dhe ultimatumet ndaj Rusisë, duke e paralajmëruar që të mos nisë një agresion ushtarak ndaj Ukrainës. Megjithatë, duket se nuk pati një vullnet të mjaftueshëm diplomatik për të gjetur një zgjidhje paqësore për situatën.

Presidenti i Ukrainës, një lider i pazakontë në politikë dhe diplomaci, dhe një ish-komedian, u gjet përpara spektatorëve më të mëdhenj në botë dhe nuk hezitoi të fillonte shfaqjen e tij teatrale.

Institucionet më të rëndësishme ndërkombëtare u hapën për të, dhe ai u shfaq si heroi që po shpëtonte Europën, si ai që po ndryshonte botën. Ndërkohë,



shtëpia e tij, Ukraina, po digjej. Ai, në fakt, po luante rolin e tij të vërtetë, duke ecur me siguri mbi tapetin e kuq të shtruar në nder të tij. Por, në vend të një kostumi formal, ai ishte veshur me një bluzë ushtarake, si të ishte duke ardhur drejtpërdrejt nga fronti i luftës. Ai shtrëngoi duar me udhëheqësit më të fuqishëm të botës dhe u prit me nderime të mëdha në çdo vend që vizitoi. Por, mes gjithë atij respekti dhe lavdërimit, ai harroi për momentin nga ishte nisur dhe pse po e bënte këtë udhëtim.

Thirrja e tij për armatime, mjete ushtarake, armë dhe avionë, në vend të një thirrjeje për paqe, e mbuloi çdo zë tjetër dhe sfumoi çdo mundësi për tu ulur në tryezën e bisedimeve.

Edhe vetë Papa Françesku ka dënuar thirrjet për armatim dhe eskalim të konfliktit në Ukrainë. Ai ka apeluar disa herë për paqe dhe përpjekje diplomatike për të gjetur një zgjidhje paqësore për luftën, duke theksuar pasojat shkatërruese që ka kjo luftë për popullin ukrainas dhe ata që po vuajnë nga tërmetet e saj. Papa ka shprehur shqetësimin për mënyrën se si armatimi ka rritur tensionet dhe ka theksuar rëndësinë e një qasjeje më

paqësore dhe të qëndrueshme për të arritur një marrëveshje. Për këto thirrje, disa zëra diplomatikë, analitikë dhe mediatikë e kanë kritikuar atë, madje duke e akuzuar për “blasfemi”, me pretendimin se ai po mbështet Rusinë me deklaratat e tij.

Që në fillim të këtij konflikti, u bë e qartë që Rusia dhe Putin nuk duhet të fitojnë. Ndaj, në vend që të ulen në bisedime, ata furnizuan me lloj-lloj armatimesh, tanke, avionë, paketa sanksionesh kundër Rusisë, etj...duke rritur oreksin rus për më shumë sulme, më shumë aneksime, ndërkohë që bota vetëm po shikonte se si po shembej rendësia dhe përgjegjësia e saj globale.

Nuk mund të themi se ishte një lajthitje e Zelenskit, te guxonte të perballej me “ariun” rus por rrahja e shpatullave dhe garancitë e dhëna nga SHBA dhe Europa bënë që Zelensky të ecte i qetë, me bindjen se ai do të ishte arkitekti i një bote të re.

Në këndvështrimin tim, Zelensky e kishte humbur luftën menjëherë pas sirenavë të para të alarmit që njoftuan raketat e para nga Rusia drejt Kievit. Me të drejtë, Zelensky iu drejtua amerikanëve me fjalët: “Na lini ne të flasim me Putinin. Ne e

njohim njëri-tjetrin.”

Por ishte e qartë që vendimet për Ukrainën nuk merreshin nga Ukraina, por nga Uashingtoni.

Një rast tjetër ishte vetëm pak ditë para pushtimit zyrtar të Rusisë në Ukrainë. Ishte po Zelensky ai që bëri thirrje për të mos krijuar panik nga SHBA, pasi Rusia nuk do ta pushtonte Ukrainën. Por reagimi i ashpër nga SHBA bëri që Zelensky të zmbrapset nga retorika të tilla. Këto janë dy momente që tregojnë qartazi se Zelensky nuk dinte se çfarë po bënte.

E pra, vendimet që janë marrë për Ukrainën dhe në emër të Ukrainës, pa prezencën e saj, janë parë që në fillim të këtij agresioni. Sot, Ukraina shpreh pakënaqësinë e saj, pasi negociatat për paqe po zhvillohen gjithashtu pa përfshirjen e saj të drejtpërdrejtë.

SHBA-ja, e cila i dha të gjitha garancitë se Ukraina do të fitonte këtë luftë, duket se nuk është më në krah të saj. Presidenti Trump ka një qasje tjetër ndaj këtij konflikti dhe administrata e tij po e sulmon Zelenskin, duke e quajtur atë një lider të paligjshëm që drejton vendin.

Personalisht duhet ta theksoj



Ukraina vërtet u përfol si arsyeja e ndryshimit të rendit të ri botëror, por askush nuk e parashikoi se ajo do të bëhej pikërisht viktimë e këtij rendi. E pikërisht linjëzimi i SHBA-së dhe Rusisë në OKB, në përvjetorin e tretë të luftës në Ukrainë, ku sulmet ndaj saj ende nuk kanë pushuar, tregon qartë se Ukraina dhe populli ukrainas janë dominoja e parë që bie përballë rendit të ri botëror.

se e kam parë me skepticizëm nisjen dhe zhvillimin e këtij konflikti. Pa dyshim, e dënoj agresionin ushtarak të Rusisë ndaj Ukrainës, sepse ky është një sulm ndaj një vendi sovran. Por, njëkohësisht, kam kritikuar faktin që nuk u morën hapa të mjaftueshëm për të nisur një dialog dhe për të kërkuar një zgjidhje diplomatike mes dy shteteve të Europës Lindore. Në vend që të përpiqeshin të arritnin një marrëveshje paqësore, u morën vetëm masa si sanksionet, kërcënimet dhe ultimatumet, por përpjekje serioze për bisedime nuk pati aspak.

Por ndërsa jemi në përvjetorin e tretë të kësaj lufte, dhe pas disa qëndrimeve aspak diplomatike e aq më tepër miqësore nga Presidenti i ri i SHBA-ve, sot ndodhem në anën e Zelenskit, ose më saktë, në mbështetje të popullit ukrainas, të cilët janë viktimë të një loje të dy fuqive globale. Ata u sakrifkuan, u vranë, u dëbuan dhe ende jetojnë nën frikën dhe pasigurinë për jetët e tyre.

Në këtë moment, mënyra si po trajtohet Zelenski dhe kritikën që i drejtohen Evropës – e cila gjithmonë ka qenë “oborri i pasmë” i politikës së jashtme amerikane, duke zbatuar çdo

kërkesë të aleatit të saj besnik strategjik – tregon se ndodhemi në mes të një loje të madhe gjeopolitike.

Kështu, aderimi i Ukrainës në NATO u paraqit si një pretekst për të forcuar sigurinë e krahut lindor të Evropës, por në të vërtetë, sot ajo përballë jo me “armikun” rus, por me aleatët e saj përëndimorë.

Por nëse Ukraina nuk antarësohet në NATO (shkaku i nisjes së kësaj lufte), atëherë, përse u bë kjo luftë në Europë?

Lufta në Ukrainë nisi për Ukrainën pa ukrainasit, ndërkohë që po diskutohet për paqen e tyre po pa praninë e tyre. Po, kush do të paguajë për qindra mijëra viktimë, miliona refugjatë që janë sot në dyert e Evropës? Kush do të marrë përsipër shkatërrimin e Ukrainës dhe pasojat që ajo ka, përfshirë dhe prishjen e aleancave me Rusinë, duke pasur parasysh se e gjithë Evropa u rreshtua në mbështetje të Ukrainës?

Sot, Ukraina po akuzohet si nxitëse dhe shkaktare e luftës trevjeçare, ndërkohë që fajtorët e vërtetë janë ata që e tërhoqën në këtë luftë. Janë ata që e armatosën, ata që i shtruan tapetin e kuq Zelenskit, duke i premtuar

aderimin në NATO dhe Bashkimin Evropian. Janë ata që e dërguan në theror dhe tani lajnë duart si “Ponci Pilat.” E pra, nëse duhet patjetër të drejtojmë gishtin ndaj një fajtori, kjo është Amerika.

Le të jemi të qartë, paqja është thelbësore, dhe ndaj saj nuk duhet hequr dorë në asnjë moment. Por revolta ime ka të bëjë me mungesën e vullnetit për tu angazhuar në bisedime dhe marrëveshje diplomatike para 24 shkurtit 2022.

Sot padiskutim, prioriteti kryesor është paqja, rindërtimi dhe rikthimi i miliona refugjatëve në shtëpitë e tyre në Ukrainë. Gjithashtu thelbësore që të ruhet stabiliteti politik dhe ekonomik në vend, për të siguruar një të ardhme të qëndrueshme dhe të sigurt për popullin ukrainas por pa coptuar Ukrainën.

Jemi të bllokuar në një lojë të dy fuqive të mëdha, që për dekada kanë qenë antagonistë të njëra-tjetrës, por duket se ato dy shtete e kuptojnë njëra-tjetrën mirë. Sikurse me administratën Biden, që “u dakordua për përplasjen e madhe në Ukrainë”, po ashtu edhe tani me administratën Trump, po dakordohen për ndarjen e përfitimeve në kurriz të Ukrainës dhe Europës.

Ukraina vërtet u përfol si arsyeja e ndryshimit të rendit të ri botëror, por askush nuk e parashikoi se ajo do të bëhej pikërisht viktimë e këtij rendi. E pikërisht linjëzimi i SHBA-së dhe Rusisë në OKB, në përvjetorin e tretë të luftës në Ukrainë, ku sulmet ndaj saj ende nuk kanë pushuar, tregon qartë se Ukraina dhe populli ukrainas janë dominoja e parë që bie përballë rendit të ri botëror.

Banka Botërore miraton 120 milionë dollarë për të mbështetur reformat në Shqipëri

Bordi i Drejtorëve Ekzekutivë të Bankës Botërore miratoi Programin e Dytë të Politikave për Qëndrueshmëri dhe Zhvillim të Gjellbër (DPL), me një financim prej 120 milionë usd për forcimin e qëndrueshmërisë fiskale dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm në Shqipëri.

Ky është financimi i dytë i një serie prej dy fazash që ndihmon vendin të përmirësojë qëndrueshmërinë fiskale dhe atë mjedisore.

BB bën të ditur se, Programi i ri do të mbështesë Shqipërinë në tri fusha kryesore reformash, të cilat synojnë:

Forcimin e hapësirave fiskale, përfshirë përmirësimin e administrimit të taksave dhe raportimit të ndërmarrjeve shtetërore mbi rreziqet e mundshme sociale dhe mjedisore.

Zgjerimin e tregut të energjisë, duke nxitur burimet e rinovueshme dhe rritjen e efikasitetit të energjisë.

Mbrojtjen e mjedisit dhe uljen e emetimeve të karbonit.

Ky program është në përputhje me Kuadrin e Partneritetit të Vendit për periudhën 2023-2027, çka përforcon angazhimin e Bankës Botërore për zhvillimin e qëndrueshëm të Shqipërisë dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për qytetarët e saj.

“Paketa e reformave që mbështesim përmes këtij programi synon të forcojë perspektivat e zhvillimit të Shqipërisë,” tha Richard Record, Menaxheri në detyrë i



Bankës Botërore për Shqipërinë. “Ky financim do ta ndihmojë vendin të adresojë sfidat kryesore në sektorin e energjisë si dhe të rrisë aftësinë e qeverisë

për të menaxhuar rreziqet fiskale dhe për të mbështetur më mirë shtresat në nevojë të popullsisë”, theksoi ai.

“Programi reflekton aspiratat e Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian, Programin e Reformave Ekonomike 2024-2026 dhe angazhimet ndërkombëtare të vendit për klimën. Masat kryesore përfshijnë forcimin e qëndrueshmërisë fiskale, përmirësimin e sistemit të ndihmës sociale dhe nxitjen e reformave në sektorin e energjisë.

Kuadri i politikave makroekonomike të Shqipërisë mbetet i qëndrueshëm, i karakterizuar nga deficit fiskali menaxhueshëm, borxh publik në rënie, politikë monetare e qëndrueshme e mbështetur nga masa dhe mbikëqyrje e kujdesshme”, thekson BB në njoftimin për shtyp publikuar në faqen zyrtare të BB.



“Programi reflekton aspiratat e Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian, Programin e Reformave Ekonomike 2024-2026 dhe angazhimet ndërkombëtare të vendit për klimën. Masat kryesore përfshijnë forcimin e qëndrueshmërisë fiskale, përmirësimin e sistemit të ndihmës sociale dhe nxitjen e reformave në sektorin e energjisë.



Kush është Friedrich Merz që do të drejtojë tani Gjermaninë?!

FRIEDRICH MERZ, një ish-bankier që nuk ka qenë kurrë ministër i ndonjë qeverie gjermane, duket pothuajse e sigurt se do të jetë kancelari i ardhshëm pasi aleanca e tij konservatore CDU/CSU fitoi shumicën e votave në zgjedhjet vendimtare federale të së dielës. Gjatë fushatës, vendimi i tij për të bashkuar votat në parlament me ekstremin e djathtë shënoi një kthesë historike dhe shumë të diskutueshme, edhe pse ai ka këmbëngulur disa herë se nuk do ta thyente kurrë “murin e zjarrit” të Gjermanisë (“brandmauer”) duke bërë një koalicion qeverisës me AfD-në e ekstremit të djathtë.

Megjithatë, sado testues të jetë peizazhi i brendshëm politik dhe ekonomik, shumë nga sfidat më urgjente, Merz-it mund t'i vijjnë nga jashtë Gjermanisë. Njeriu që dikur merrte lavdërime duke pretenduar se mund të thjeshtonte jetën e miliona njerëzve duke ulur taksat do të përballet me një realitet krejt më kompleks.

Merz, një aviator i shkathët dhe baba i martuar i 3 fëmijëve, gruaja e të cilit e pengoi të blinte një avion privat derisa fëmijët të dilnin nga shtëpia (tani thuhet se ka dy avionë) po shpreson të lërë gjurmë në politikën gjermane. Më poshtë është një vështrim i shkurtër i karrierës së tij.

Marrëdhëniet me SHBA

Pasi u prezantua që herët në fushatën zgjedhore si një biznesmen i vendosur, i cili ishte i pajisur mirë për të bërë

marrëveshje ballë për ballë me “tregtarin” Donald Trump, Merz u detyrua të ndryshonte qëndrimin e tij brenda pak orësh pasi presidenti i SHBA-së ktheu narrativën mbi luftën e agresionit të Rusisë ndaj Ukrainës.

Trans-atlanticisti dikur optimist mori dozën e tij të parë të real-politikës para se të fitonte detyrën e lartë. Kjo pasi retorika e tij ndryshoi shpejt për raportet me Trump. Merz nuk bëri asgjë për të fshehur tronditjen e tij pas deklaratave të Trump që fajësonte Ukrainën për luftën. Merz e quajti atë “një përmbyse klasike e rrëfimit autor-viktime”.

“Kështu e ka paraqitur Putini prej vitesh dhe singlerisht jam disi i tronditur që Donald Trump tani e ka bërë të tijën”, – tha ai, duke iu referuar Trump si “një admirues i sistemeve autokratike”.

Të biesh pre e emocioneve, tha ai, nuk do ta çonte Evropën askund. “E vetmja gjë që mund të bëjmë, nëse kemi një ide të ndryshme për demokracinë është që të bashkojmë vepimet tona në Evropë sa më shpejt që të jetë e mundur.” Megjithatë sfida është e madhe. Prishja brenda natës në marrëdhëniet midis Uashingtonit dhe Berlinit, e cilësuar nga Merz në terma të paqartë si një “ndarje epokale”, ka të ngjarë të bëhet elementi përcaktues i qeverisë së tij.

Me siguri kjo do të dom-



inojë në që ishte një tabaka tashmë e mbingarkuar. Si udhëheqës i ekonomisë më të madhe të Evropës, trajtimi i krizës nga ana e tij do të jetë vendimtar për mënyrën sesi kontinenti do të përballë me një rend të ri botëror.

“Është ekonomia budalla!”

Ekonomia më e madhe e Evropës ka nevojë për një rindezje. Sfidat janë të shumta, nga mbirregullimi dhe rrënimi i infrastrukturës, te kostot e larta të energjisë, mungesa kronike e specialistëve dhe plakja e popullsisë. Ka, thonë shumë gjermanë, një nevojë urgjente për investime në çdo gjë, nga mbrojtja e vendit deri te infrastruktura e tij.

Por, duke bërë këtë, ka të ngjarë që Merz të lehtësojë një rregull të mbrojtur me kushtetutë, që njihet si “frena e borxhit”, i cili për vite është përdorur nga Berlini për të pretenduar statusin e tij shumë të lavdëruar si një shembull i disiplinës fiskale.

Nën frenimin e prezantuar në 2009 nga Angela Merkel për të treguar se Gjermania ishte e përkushtuar për të balancuar llogaritë pas krocës bankare, qeverisë federale i kërkohet të kufizojë huamarrjen vjetore në 0.35% të PBB-së.

Merz mund ta rregullojë këtë dhe nga ana tjetër të çlirojë fondet e nevojshme për investime në gjithçka, nga banesat, tek infrastruktura hekurudhore, të cilat më shumë se gjysma e gjermanëve i mbështesin. Por edhe kjo nuk do të kalonte pa polemika. Në të vërtetë, ishte një mosmarrëveshje për “frenimin e borxhit” që në fund rrëzoi qeverinë e Olaf Scholz.

Ukraina

Ukraina është tashmë një “mollë e madhe sherri” në Gjermani. Ekziston një ndarje e qartë në popullatë midis atyre që besojnë se mbështetja për Kievin sjell kërcënimin e luftës më afër Gjermanisë, një preten-



dim i fuqishëm i bërë nga lëvizja “konservatore e majtë” Sahra Wagenknecht (BSW) dhe atyre që besojnë se mosmbështetja e saj dhe shfaqja e dobësisë përballë Vladimir Putinit është edhe më e rrezikshme.

Merz qartazi bën pjesë në kampin e dytë. Ai e paralajmëroi Scholz-in kundër adoptimit të “një politike qetësuese” ndaj Rusisë dhe vizitoi Kievin edhe përpara kancelarit të atëhershëm.

Gjermania është ofruesi i dytë më i madh i furnizimeve ushtarake për Ukrainën, dhe Merz e ka mbështetur me zjarr këtë, duke thënë se do të dëshironte të shkonte edhe më tej duke i ofruar Ukrainës raketa me rreze të gjatë “Taurus”. Ai gjithashtu ka të ngjarë të përballë me thirrje për të dërguar trupa gjermane në Ukrainë si pjesë e një force parandaluese ose paqeruajtëse, një diskutim që Scholz e ka përshkruar si “plotësisht të parakohshëm”.

E djathta ekstreme gjermane

Çështja se me kë do të kërkojë Merz të hyjë në koalicion dhe nëse ai do të vazhdojë të përjashtojë mundësinë e formimit të një qeverie me AfD-në e ekstremit të djathtë, është më e rëndësishmja në mendjen e elektoratit. Vendimi i Merz në janar kur sinjalizoi pranimin e thyerjes së një tabuje ndaj AfD-së për mbështetjen e një “plani 5 pikash” jo-detyrues për kontrollë më të forta kufitare ishte një pikë kthese në atë që kishte qenë një fushatë zgjedhore disi e acaruar. Që atëherë ai ka këmbëngulur vazhdimisht se një koalicion CDU-AfD nuk është në plan. Por shumë kanë frikë se një qeveri koalicioni të paqëndrueshëm dhe të përcarë do të çojë në një përsëritje të ngërçit dhe konfliktit që përcaktoi administratën fatkeqe të “semaforit” të Scholz.

Dhe frika është se kjo mund të hapë pa dashje rrugën për një koalicion CDU-AfD me një udhëheqës të ri, më pak ngurrues në zgjedhjet e ardhshme të mundshme në 2029-ën.

EUROPA SHTRËNGON RRADHËT! Aleanca Euro – Atlantike në rrezik! SHBA-1945!! Duam Paqe, jo Pushtim!

REALPOLITIK FLASH NR. 103 | 16 SHKURT – 1 MARS 2025 | EKSKLUZIVISHT PËR ARGUMENTUM

Komente “flash” mbi 4 ngjarjet kryesore diplomatike, shkurt dhe shqip, vetëm me 1000 fjalë nga analisti i njohur

DR. JORGJI KOTE *GRAND MASTER*

1.

Europa shtrëngon rradhët! Tamam kur nga të gjithë pritej një fillim i ri premtues midis SHBA-ve dhe Europë, mbas instalimit të lidiershipeve të reja në Uashington dhe në Bruksel, në dritën e zhvillimeve të reja, sidomos në Ukrainë, në prag dhe të të 3 vjetorit të agresionit rus, ndodhi ajo që nuk ishte imagjinuar.

Presidenti i sapozgjedhur Donald Trump me shumë deklarata të tij dhe bashkëpunëtorët më të ngushtë kanë sulmuar ashpër BE-në, politikat e saj dhe kanë lënë të kuptohet se ajo mund të jetë konkurente dhe kundërshtare por jo më aleate strategjike. Madje ditët e fundit Trump pohoi se BE-ja u krijua për të shtrydhur SHBA-të, diçka jo e vërtetë. Ndërkohë, SHBA-të kanë kaluar në sulm frontal kundër BE-së dhe vendeve të saj kryesore, sidomos Gjermanisë në një luftë ideologjike, politike, ekonomike dhe tregtare, duke vendosur së fundi taksa 25 për qind për importet nga BE-ja. Në këto kushte, Europa me



të drejtë po u bie kampa-nave të alarmit dhe ka nisur të shtrëngoje rradhët. Për të mbrojtur tanimë jo vetëm vlerat dhe parimet themelore, por dhe interesat, mbijetesën e vet politike, ekonomike dhe fizike! Dhe e ka filluar këtë me diplomacinë e saj të ecejakeve në Uashington, në Bruksel dhe në metropooet e tjera ndërkombëtare. E filloi Presidenti Macron që ftoi në Elizée shumë liderë kryesorë, disa ditë më parë ai priti në Paris Kancelarin e ri gjerman Friedrich Merz në një takim tejet miqësor dhe premtues për të ardhmen e boshtit franko-gjerman të BE-së. Javën e kaluar ai dhe Kryem-

inistri britanik Starmer ishin në Uashington ku takuan Presidentin Trump më 28 Shkurt ishte atje Presidenti ukrainas Zelenski; të dielën, më 2 Mars, Kryeministri Starmer ka ftuar në “Downing Steet 10” shumë kolegë të tij europianë për të diskutuar posaçërisht mbi këto tema, 2 ditë mbas “të premtes së zezë” me Zelenskin në Shtëpinë e Bardhë dhe 4 ditë përpara Samitit të jashtëzakonshëm të BE-së në Bruksel më 6 Mars. Ndërkohë, Europa ka filluar përgatitjet për të siguruar autonominë e saj mbrojtëse dhe strategjike tashmë dhe PA SHBA-të, në mbrojtje të integritetit të saj territorial. BE-ja i

ka mjetet dhe mundësitë, kërkohet vetëm vullneti politik, vendosmëria dhe pak kohë sa të vihet në lëvizje makineria e saj mbrojtëse. Ka dhe aleatë të fuqishëm si Britaninë e Madhe, pse jo dhe Turqinë, të cilat mbas SHBA-ve kanë ushtritë më të fuqishme të NATO-s. Franca dhe Britania kanë dhe armët atomike, ombrella e të cilave mund të zgjerohet për të mbrojtur dhe vende të tjera. Ja pse tani Europa po ve në zbatim aforizmën e njohur “Nëse do paqe, përgatitu për luftë”!

2.

Aleanca Euro – Atlantike në rrezik! Madje shumë më të të madh mbas krisjes së pariparueshme që ka marrë gjatë dy muajve të fundit. Aleanca më e madhe politike dhe ushtarake është çarë me dysh. Është ndarë për dhe në vlera dhe parimet themelore demoratike perendimore si dhe në interesat dhe garancitë për mbrojtje. Është vënë në diskutim dhe vetë Neni 5 i NATO-s mbi mbrojtjen kolektive, duke u kapur pas “gërmave” sepse fryma solidare është e qartë. SHBA-të sponsorizoi rezolutën për përfundimin e luftës në Ukrainë por aty nuk përmendet agresori, ai që nisi luftën. Kjo përçarje ndodhi në pikën më delikate, ku NATO duhet të shfaqë forcën e saj, me luftën dhe paqen në Ukrainë. Dhe në takimin e dështuar dhe skandal Trump-Zelenski me 28 Shkurt Trump e shpalli publikisht se nuk do japin garancitë e sigurisë për një paqe të qën-

drueshme në Ukrainë; edhe pse Ukraina ra dakord t’i japë mineralet e rralla në kuadrin e një bashkëpunimi të gjerë ekonomik tani dhe mbas përfundimit të luftës. E keqja tjetër e madhe është se kjo aleancë po kërkohet të kontabilizohet, kur në krye të saj janë vlerat dhe parimet themelore dhe interesat të përbashkëta të SHBA-ve dhe BE-së.

3.

SHBA 1945! Po, kështu mund të thuhet mbas dy muajve të fundit. Për herë të parë mbas 80 vitesh, SHBA-të, pionierja dhe kampione e demokracisë liberale, e paqes, e tregtisë së lirë, e diplomacisë shumëpalëshe dhe e rendit të ri botëror ka venë në krye ligjin e forcës mbi forcën e ligjit, bën ujdira me Rusinë pa asnjë fjalë të keqe ndaj saj; ndërkohë që nuk kursehet të qortojë ashpër aleatët e saj, Britaninë, Francën, Gjermaninë, Kanadanë, Danimarkën, Ukrainën, BE-në. Vërtet që mbas 4 vitesh mund të vijë një President tjetër më Euro-Atlantik në Shtëpinë e Bardhë, por dëmi u bë, buka dhe zemra Euro-Atlantike u thye dhe nuk ngjitet më.

4.

Paqe jo pushtim! Kjo është pyetja që shtrohet lidhur me paqen në Ukrainë, sidomos pas takimit të 28 Shkurtit Trump – Zelenski. Është folur shumë për këtë projekt me ndërmjetësimin amerikan, por që ka shumë PA negative: Pa BE-në, PA Ukrainën, PA NATON, pa Kinën dhe vende të tjera të

mëdha, PA garanci sigurie, pa procedura....

Tentativa të tilla si këto janë të destinuara të dështojnë. Sepse le ta qartësojmë dhe njëherë realisht. Dy janë alternativat për paqe të vërtetë dhe të qëndrueshme:

E para, lufta deri në fitoren përfundimtare të Ukrainës me ndihmën dhe mbështetjen e SHBA-vë, BE-së, etj. Me garanci ligjore nga Rusia që nuk do të ndërmarrë më akte të tilla agresioni; anëtarësimi i Ukrainës në BE dhe në NATO.

E dyta, vendosja e armëpushimit, ndalimi i luftimeve, tërheqja e trupave ruse dhe fillimi i negociatave me garancitë e duhura. Me lëshimet e rastit nga të dyja palët dhe një afat më i gjatë kohor për hyrjen e Ukrainës në NATO, etj.

E treta, paqja si kjo që propozohet tani me shumë PA-ra dhe mbi të gjitha pa garanci sigurie nga SHBA-të. Mirëpo kështu nuk do të jetë më paqe, por pushtim i ri dhe kapitullim i Kievit dhe i Aleancës Perendimore. Duke hapur “kutinë neoimperialiste të Pandorës”! Për pasojë, nuk do të ketë më garanci as për Ukrainën, as për Europën dhe NATO-n; sepse Rusia do të vijojë me synimet e saj agresive ndaj vendeve të tjera, duke përfshirë dhe ato të BE-së dhe NATO-s.

Ndaj tani Europa po kërkon dhe aleatë të tjerë. Ajo po rimendon dhe rindërton vetvehten, me koncepte, praktika dhe aleanca të reja gjeopolitike, që të mbrojnë vehten dhe popujt dhe vetë projektin e nisur 67 vite më parë, për paqe, siguri, begati dhe demokraci të vërtetë liberale. Europa nuk mundet dhe nuk do të bjerë!

Zgjedhjet parlamentare në Kosovë

Kush, sa vota mori?



Lendi Susuri (RFE/RL Graphics)

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka publikuar të enjten numrin e votave që kanë fituar kandidatët për deputetë të Kuvendit të Kosovës, në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit, pas numërimit të mbi 90 për qind të votave në vendvotime.

Sipas rezultateve të publikuara në faqen e KQZ-së deri rreth orës 13:30, liderët e partive kryesore dhe kandidatët për pozitën e kryeministrit renditen kështu:

- Albin Kurti, lider i Lëvizjes Vetëvendosje dhe kandidat për kryeministër – 259.532 vota
- Bedri Hamza, kandidat për kryeministër nga Partia Demokratike e Kosovës – 150.294 vota
- Memli Krasniqi, lider i Partisë Demokratike të Kosovës – 85.293 vota

Personi më i votuar në Kosovë vazhdon të mbetet presidentja aktuale e Kosovës, Vjosa Osmani, e cila në zgjedhjet e vitit 2021, pati fituar 300.756 vota.



- Lumir Abdixhiku, lider i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe kandidat për kryeministër – 109.202 vota
- Ramush Haradinaj, lider i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe kandidat për kryeministër – 37.752 vota
- Zllatan Ellek, lider i Listës Serbe – 9.354 vota.

Në rezultatin e publikuar nuk përfshihen votat me kusht, votat e personave me nevoja të veçanta dhe mbi 80 mijë vota nga diaspora.

Personi më i votuar në Kosovë vazhdon të mbetet presidentja aktuale e Kosovës, Vjosa Osmani, e cila në zgjedhjet e vitit 2021, pati fituar 300.756 vota.

Dalja në zgjedhjet e sivjetme ishte 40 për qind – rreth 8 për qind më e vogël sesa në zgjedhjet e 2021-tës.

Lëvizja Vetëvendosje (LVV) – parti në pushtet – ka dalë e para në këto zgjedhje, me 40.80 për qind të votave, e pasuar nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me 22.03 për qind të votave, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 17.63 për qind të votave, koalicioni mes Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Nismës



Dhjetë përgurat më të votuara në Lëvizjen Vetëvendosje, pas Kurtit, janë: Glauk Konjuca me 199.136 vota, Faton Peci me 96.849 vota, Hekuran Murati me 94.531 vota, Albulena Haxhiu me 89.601 vota, Xhelal Sveçla me 85.632 vota, Donika Gërvalla me 79.691 vota, Avni Dehari me 68.735 vota, Mimoza Kusari – Lila me 61.945 vota dhe Arben Vitia me 48.760.

Socialdemokrate ka marrë 7.46 për qind të votave, si dhe Lista Serbe 4.61 për qind të votave. Partitë tjera kanë fituar përqindje më të vogël të votave. Me Ligjin e ri për zgjedhjet, votat e kandidatëve për deputetë numërohen ndaras në Qendrat Komunale të Numërimit. Ky proces ka nisur me vonesë, ndërsa organizatat për monitorim të zgjedhjeve e kanë kritikuar vetë KQZ-në se nuk është përgatitur mjaftueshëm mirë për procesin.

Kush u ngjiti në krye të listës? Dhjetë figurat më të votuara në Lëvizjen Vetëvendosje, pas Kurtit, janë: Glauk Konjuca me 199.136 vota, Faton Peci me 96.849 vota, Hekuran Murati me 94.531 vota, Albulena Haxhiu me 89.601 vota, Xhelal Sveçla me 85.632 vota, Donika Gërvalla me 79.691 vota, Avni Dehari me 68.735 vota, Mimoza Kusari – Lila me 61.945 vota dhe Arben Vitia me 48.760.

Nga radhët e PDK-së, pas Hamzës dhe Krasniqit, më të votuarit janë: Uran Ismaili me 37.017 vota, Vlora Çitaku me 34.805 vota, Sala Jashari me 32.052 vota, Përparim Gruda me 27.004 vota, Jakup Nura me 26.635 vota, Rrahman Rama me 25.532 vota, Nait Hasani me 24.162 vota dhe Elmi Reçica me 23.163.

Nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, pas Abdixhikut, më të votuarit janë: Doarsa

Kica Xhelili me 44.738 vota, Hykmete Bajrami me 41.796 vota, Kujtim Shala me 37.886 vota, Avdullah Hoti me 30.932 vota, Anton Quni me 27.292 vota, Lutfi Haziri me 27.260 vota, Jehona Lushaku Sadriu me 22.122 vota, Armend Zemaj me 19.341 vota dhe Imri Ahmeti me 18.397 vota.

Në listën e koalicionit mes AAK-së dhe Nismës, pas Haradinajt, më votuarit janë: Fatmir Limaj me 22.207 vota, Time Kadriaj me 12.976, Bekë Berisha me 12.972 vota, Ardian Gjini me 9.757 vota, Xhevahire Izmaaku me 9.439 vota, Gani Bajraktari me 8.970, Albana Bytyqi me 8.398 vota, Besnik Tahiri me 8.006 vota dhe Pal Lekaj me 7.845 vota.

Nga kandidatët e Listës Serbe, më së shumti vota ka marrë Branislav Nikolliq nga Shtërpca, gjithsej 12.331 vota. Nikolliq është vëllai i Bratislav Nikolliqit, ish-kryetarit të Komunes së Shtërpces.

Pas tij renditet Sërgjan Popoviq nga Graçanica me 11.329 vota të fituara, si dhe Lila Stefanoviq nga Mitrovica e Veriut me 11.231 vota. Lilana Stefanoviq, përndryshe, është ish-kryetare e Gjykatës Themelore në Mitrovicën e Veriut, e cila ka dhënë dorëheqje, në kuadër të largimit kolektiv të serbëve nga institucionet e Kosovës, në nëntor të vitit 2022.

Bartësi i Listës Serbe, Zllatan Ellek, sipas rezultateve aktuale, është në vendin e shtatë për nga numri i votave të fituara – 9.354. Para tij, në vendin e katërt është Sllavko Simiq me 10.752 vota, në vendin e pestë Verica Çeraniq me 10.412 vota, ndërsa në vendin e gjashtë Igor Simiq me 10.391 vota të fituara. Në vendin e tetë është Milana Nikolliq me 8.163 vota, në të nëntin Stefan Kovaçeviq me 7.635 vota, dhe në të dhjetin, Novak Zhiviq me 6.612 vota.

Lëvizja Vetëvendosje, e cila ka siguruar më së shumti vota në këtë proces zgjedhor, është zotuar se do ta formojë Qeverinë e re, ndonëse me rezultatet aktuale, ajo nuk i ka 61 deputetë për miratim të kabinetit të ri qeveritar.

Analistët politikë kanë përmendur mundësinë e bashkimit të forcave të LVV-së me komunitetet joserbe, që i kanë 10 ulëse të garantuara në Kuvend. Partitë opozitare, PDK, LDK, dhe AAK, kanë hedhur poshtë mundësinë e krijimit të koalicionit me LVV-në dhe kanë shprehur gatishmëri për formimin e një Qeverie së bashku.

Njohësit e çështjeve politike paralajmërojnë se në ditët dhe javët në vijim, Kosova rrezikon të përballlet me turbulencë politike, për shkak të thellimit të ndasive mes partisë në pushtet dhe atyre në opozitë. /REL

Mickoski në Uashington: Evropa duhet të jetë parimore dhe jo me standarde të dyfishta

Kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Hristijan Mickoski, ka deklaruar se që nga fillimet e pavarësisë nga ish-federata jugosllave dy synimet strategjike të vendit të tij kanë qenë anëtarësimi i plotë në NATO dhe Bashkimin Evropian (BE), si dhe ka theksuar se Evropa duhet të jetë parimore dhe jo me standarde të dyfishta. Siç njofton qeveria e Maqedonisë së Veriut, kryeministri Mickoski mbrëmë foli në Konferencën e Veprimet Politik Konservator (CPAC), një mbledhje politike vjetore e Partisë Republikane në Washington.

